



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 1 shkurt 2017, në mbledhjen e XXXVI-të
(tridhjetëgjastë), të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.05'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekaliu, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Mrika Thaqi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Muharrem Haziri, OSBE.

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, pas dërgimit të thirrjes dhe materialit për këtë mbledhje, jam informuar se është paraqit nevoja për shqyrtim të një çështjeje të natyrës së ngutshme dhe e ftoi Abaz Llugaliun të paraqet arsyeshmërinë.

z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, më 26 janar 2017, na është dërguar një kërkesë për sigurimin e një lokacioni në sipërfaqe prej 1500 m² për ndërtimin e objektit të Qendrës së Aftësimeve Profesionale, objekt i cili nga donacioni i Ministrisë së cekur do të ndërtohet në Komunën tonë, projekt i cili aktualisht është në fazën e projektit ideor.

Gjatë ditës së sotme e kemi kufizuar parcelën në sipërfaqe prej 1500 m², në afërsi të objektit të Kryqit të kuq, në rrugën për fshatin Letanc.

Mjetet financiare për këtë projekt janë të siguruara, andaj me qëllim që të fillohet sa më parë realizimi i të njëjtit, propozoj që ta mbështetni këtë propozim dhe t'i rekomandoni Kuvendit për shqyrtim.

z. Haki Rudari, theksoi, është krijuar një praktikë që për mbledhje të paraqiten pika shtesë të rendit të ditës, megjithatë jam i mendimit se kjo praktikë duhet të ndërpritet.

Ne gjatë vizitave në terren kemi hasur në raste ku kemi ndërtim të pompave të karburanteve të naftës e gjatë ndërtimit të tyre fare nuk merret askush me to, por pas funksionalizimit të tyre bëhen kërkesat për legalizim. Gjithashtu kemi pasë raste të objekteve hoteliere të cilat kanë funksionuar dhe shumë kohë më pas i kemi shqyrtuar kërkesat e tyre për ndërtim të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore. Pra unë personalisht dhe grupi i këshilltarëve i LVV – së jemi kundër këtyre praktikave edhe pse rasti konkret është i arsyeshëm por materiali duhet të dërgohet me kohë.

z. Naim Çunaku, theksoi, duke u bazuar në atë që e prezantoi drejtori z. Abaz Llugaliu e në veçanti arsyeshmërinë të cilën e paraqiti për përfshirje të kësaj çështjeje në rend dite që të mos vonohen procedurat për realizimin e këtij projekti i cili do të sjellë të mira për qytetarët tanë, unë jam i mendimit ta mbështesim këtë propozim në mënyrë që ne të mos bëhemi pengesë për ndërtimin e Qendrës së Aftësimeve Profesionale.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket praktikave të cilat i përmendi z. Haki Rudari ne duhet të marrim për bazë se kjo kërkesë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është dërguar më 26 janar 2017, dhe shtrohet pyetja kur ka arritur në Komunë, pra kjo kërkesë është dërguar pasi neve na është dërguar thirrja dhe materiali për këtë mbledhje dhe nuk ka mundur të përfshihet në rendin e propozuar të ditës, pra arsyeshmëria është e qëndrueshme, përndryshe ndërtimi i objektit të asaj qendre është mjaft i rëndësishëm.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i ka paraparë mjetet për këtë objekt dhe nëse realizimi i këtij projekti vonohet në fund të vitit ato mjete shkojnë në deficit, andaj duhet të jemi shumë të kujdesshëm.

z. Kadri Avdiu, theksoi, në parim pajtohem me vërejtjen e z. Haki Rudarit, por në rastet kur ka të bëjë me interesat e përgjithshme të qytetarëve, nuk duhet t'i përmbahemi disa kriterëve, ashtu siç është rasti konkret për të cilin nuk kemi çfarë të mendojmë, pra pa hezitim duhet ta përfshijmë në rend dite dhe atë vetëm për të mos vonuar procedurat e realizimit të këtij projekti, ngase në rastet kur po vonohen procedurat ne po bëjmë vërejte përse po ndodhin raste të tilla.

z. Fidan Rekalii, theksoi, Grupi i këshilltarëve i LDK – së, e mbështet këtë propozim dhe është i mendimit se është një projekt shumë i rëndësishëm i cili do të ndikojë në përgatitjen profesionale të të rinjve dhe të rejave llapjane.

z. Haki Rudari, theksoi, në parim gjithherë kam qenë për realizimin e projekteve në interes të qytetarëve, pra nuk jam kundër investimeve por jam për atë që të respektohet Rregullorja e punës dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, lidhur me këtë propozim u paraqiten sqarimet në detaje dhe shtoi, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me buxhetin e vitit 2017 e ka paraparë realizimin e këtij projekti, andaj kërkesa e ministrisë së cekur është e mirëpritur e kjo u dëshmuar nga diskutimet e anëtarëve të këtij Komiteti.

Pas votimit u konstatua se me 9 vota për, asnjë kundër dhe 1 votë të përmbajtur, u miratua rendi i propozuar i ditës me rekomandim që në rend dite për mbledhjen e Kuvendit të datës 2 shkurt 2017, të përfshihet edhe:

- Propozimi i Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të paluajtshmshërisë në pronësi të Komunës, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për ndërtimin e Qendrës së aftësimeve Profesionale

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjet e Komitetit për Politikë e financa më 27 dhjetor 2016

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Informatë për përfundimin e suksesit të nxënësve në gjysmëvjetorin e parë dhe fillimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2016 – 2017

z. Avni Malolku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekalii, theksoi, Grupi i këshilltarëve i LDK – së e mbështet këtë Informatë dhe shtoi, ne të gjithë duhet të angazhohemi që të kemi arsimin sa më cilësor dhe jam i mendimit se është mjaft e rëndësishme të funksionoj koordinimi i aktiviteteve në mes shkollës, prindërve dhe nxënësve, pra ky është një trekëndësh i cili duhet të fuqizohet edhe më shumë. Gjithashtu është e nevojshme që të ngritët përkujdesja e prindërve për fëmijët e tyre por njëkohësisht konsideroj se edhe drejtorët e Shkollave duhet ta thellojnë bashkëpunimin me prindër, kuptohet përmes kujdestarëve të klasave, në mënyrë që prindërit të informohen për angazhimin e fëmijëve të tyre në procesin mësimor.

Edhe më parë e kam përmendur se shkollat duhet të praktikojnë edhe aktivitete të ndryshme rekreative në mënyrë që shkollat të jenë më tërheqëse për nxënësit.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, theksoi, në këtë Informatë në mënyrë të përgjithshme janë paraqitur të dhëna për numrin e shkollave, dy faqe e gjysmë, por edhe për gjendjen aktuale në lëmin e arsimit, mirëpo gjendja në arsim nuk është e kënaqshme jo vetëm në komunën tonë por edhe në gjithë Republikën e Kosovës.

Edhe fillimin e gjysmëvjetorit të dytë të këtij viti në shumë shkolla janë përcjellë problemet e viteve paraprake konkretisht në aspektin e ngrohjes për çka drejtori i Drejtorisë së Arsimit me kohë është dashtë të bëjë përgatitjet e nevojshme duke e llogaritur edhe pushimin shtesë të lejuar nga MASHT – i

I kam disa informacione se në SHFMU “ Ibrahim Rugova “ se fëmijëve në mësimet parashkollore dhe nxënësve të klasave të para nga mësimdhënësit dhe drejtori i Shkollës u është thënë të mos vijnë në mësimet derisa të përmirësohet koha, jam i mendimit se diçka e tillë nuk do duhej të ndodhte ngase përgatitjet për sezonin e dimrit do duhej të bëheshin me kohë, pra për këtë nuk ka kurrfarë arsyesimesh. Lidhur me këtë nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit kërkoj sqarime se ky rast a ka ndodh vetëm në shkollën e cekur apo edhe shkolla të tjera.

Gjithashtu është e nevojshme të konkretizohen aktivitetet nga të gjitha institucionet relevante për tejkalimin e gjendjes sipas rezultateve të testit Pisa, test i cili është shumë zhgënjyes në sferën e arsimit.

Në një gjendje të këtillë gjendja duhet të paraqitet në mënyrë më konkrete për të gjitha çështjet duke përfshirë edhe transparencën e intervistimit për drejtor të shkollave, mua nuk më pengon kur në kushte të barabarta për drejtor të ndonjë shkolle zgjedhet personi i cili i përket subjektit politik LDK, por sigurisht se më pengon kur ndonjë person zgjedhet drejtor shkolle vetëm për atë se është në LDK.

Sa i përket aktiviteteve rekreative në shkolla, që u përmend gjatë diskutimeve, ne jemi në dijeni se në rreth 30 shkolla lënda e Edukatës fizike nuk mbahet fare për shkak të mos ekzistimit të kushteve e kjo është shumë e paarsyeshme.

Sa i përket punësimit të kuadrove në arsim, jemi të informuar për mënyrën se si përzgjidhen lëndët profesionale, po ashtu jemi të informuar se si në Shkollën “ Ibrahim Rugova “ është eliminuar një profesor shumë i nderuar dhe në vend të tij është pranuar një përkthyes i gjuhës angleze, në këtë mënyrë është e pamundur të ngritet performanca e rezultateve të testit Pisa.

Në fund, e kam një kërkesë e ajo ka të bëjë që me rastin e publikimit të konkursit për bursa, të jetë edhe numri i pikëve sipas kriterëve përkatëse të cilat mund t'i fitojnë studentët apo nxënësit, në mënyrë që përfituesit paraprakisht të jenë të informuar se sa pikë duhet t'i kenë për ta përfituar bursën.

z. Kadri Avdiu, theksoi, ne jemi duke e shqyrtuar një informatë në të cilën afërsisht është paraqitë gjendje reale, mirëpo mua më brengosë gjendja shumë e keqe në nivel të vendit. Jeni në dijeni se në mbledhje të Kuvendit disa herë e kam thënë se politika duhet t'i heqë duart sidomos nga arsimi ngase nëse në këtë aspekt dështojmë atëherë do të dështojmë në të gjitha aspektet tjera.

Jemi në dijeni se tek ne një ndërtimi i një objekti shkollor ka zgjatë 7 – 8 vite dhe ka kushtuar rreth 2 milion euro dhe pas funksionalizimit uji rrjedh nga kati i dytë deri në katin përdhese e kjo do të thotë se punimet në atë objekt nuk janë kryer. E keqja është se në lëmin e arsimit i kemi dy nivele të kompetencave dhe atë të nivelit qendror dhe nivelit lokal, nivele të cilat nuk mund t'i harmonizojnë qëndrimet për shkak se i takojnë subjekteve të ndryshme politike. Jam i mendimit se nëse dëshirojmë arsim cilësor duhet të jetë një vijë e përgjithshme institucionale pa ndërhyrje partiake.

Mua më së tepërmi më brengos që kuadrot dhe nxënësit që kanë dije dhe aftësi të ecin përpara nuk i mbështesim por e bëjmë të kundërtën ata ne i dëmtojmë. Gjithashtu dihet se ka raste që provimet kryhen përmes një thirrjeje telefonike dhe shtrohet pyetja çfarë të bëjnë nxënësit të cilët nuk e kanë askënd për të intervenuar.

E përmenda cilësinë e punimeve të objektit të ri të Gjimnazit në të cilin është përdor llamarina me cilësinë më të dobët që mund të gjendet në treg e të mos flasim për trashësinë që është rreth 1 mm. , normal kjo e lëshon ujin dhe e dëmton objektin.

Sa i përket rezultatit të testit Pisa, ne edhe para publikimit të këtyre rezultateve është dashtë të dimë gjendjen që e kemi në arsim.

Kemi raste që mësimit në orë të mësimit merren me politikë dhe me atë se kush është patriot e kush tradhtar, andaj duhet të krijojmë mekanizma që mësimit në orë të mësimit e pandërgjegjshëm dhe ata që nuk e meritojnë këtë profesion të largohen nga puna, pra këto ndryshime duhet bërë duke filluar nga niveli qendror e deri te niveli lokal.

z. Haki Rudari, theksoi, konsideroj se arsimi ka nevojë për një politikë serioze, të ndershme, të përgjegjshme dhe pa anime politike.

Infrastruktura në shkolla është dashtë të jetë më në nivel, furnizimet të jenë më të mëdha, jemi në dijeni se në shumë shkolla mungojnë fotokopjuesit, aparat që është shumë i

nevojshëm. Në shkollën që unë punoj një klasë është pa derë e këtë çështje ne si Komitet kemi mund ta zgjidhim ngase nuk kushton shumë por ka edhe shumë çështje të tjera që kemi mundur t'i zgjidhim.

Edhe më parë e kam ngritur çështjen e ndarjes së bursave dhe në mbledhje kam thënë fundja bursa le ti jepet një anëtar të LDK – së por që i ka kushtet ekonomike – sociale të vështira, por jo atij që i ka dy apo tre anëtarë të punësuar, parim i njëjtë mund të zbatohet edhe në ndarjen e subvencioneve në bujqësi, pra të subvencionohen bujqit të cilët vërtet kanë nevojë. Në dy çështjet e cekura unë i kam vërejtjet e mia, andaj konsideroj se në këtë drejtim duhet të ngritët transparenca.

Sa i përket rezultateve të testit Pisa jam i mendimit se përgjegjësia është e të gjithëve, pra e Qeverive të mëparshme dhe kësaj aktuale, e ministrave të Ministrive përkatëse, Drejtorive Komunale e pastaj e mësimdhënësve dhe në fund radhiten prindërit dhe nxënësit. Andaj nuk pajtohem me ata të cilët gjithë përgjegjësinë e bartin tek mësimdhënësit, pra unë jam për atë që çdo kush ta merr përgjegjësinë e vet.

Pajtohem me thënien e drejtorit z. Avni Maloku, se është i nevojshëm një mobilizim në mënyrë që secili ta merr përgjegjësinë e vet dhe të ngritët cilësia në arsim, që aktualisht të gjithë pajtohem se nuk është në nivelin e duhur.

Drejtorët e shkollave zgjedhën nga radhët e LDK – së por duhet pasë kujdes që të zgjedhën ata të cilët menaxhojnë mirë e jo atillë që pasi të zgjedhën bëjnë diferencime në shkollën përkatëse, bëjnë ndarje dhe e prishin harmoninë e punës, e këta edhe partisë që është në pushtet nuk i bëjnë nderë.

z. Bahri Blakçori, theksoi, drejtori i Drejtorisë së Arsimit, në fjalën hyrëse, i përmendi aktivitetet e ndërmarra në kuadër të përgjegjësisë të asaj Drejtorie, mirëpo unë do të përqendrohem në rezultatet e suksesit të nxënësve sipas cikleve përkatëse ku në nivelin e parë nota mesatare është 4.22, mesatare shumë e lartë por shtrohet pyetja sa është reale, a kanë qenë mësimdhënësit dorëlibër, apo ka ndikuar afërsia me fëmijë në kuptimin e përkrahjes. Në nivelin e dytë (kl. VI – IX) që mesatarja e notave është 3.07, edhe në këtë rast jam i mendimit se është mbi mesatare, nëse merret mesatarja e këtyre dy niveleve është mesatare e mirë dhe krahasuar me testin Pisa rezulton se diç nuk është në rregulle me vlerësimin. Tek niveli i tretë që është 2.37 na mbetet që në gjysmëvjetorin e dytë do të jetë më mirë.

Në rezultatet e Pisa jam i mendimit se ndikojnë shumë faktorë, mirëpo pajtohem me z. Haki Rudari se e gjithë barra nuk duhet të bartet vetëm tek mësimdhënësit por edhe te subjektet tjera të ndërlidhura me këtë proces.

Tani jemi duke e zbatuar kurikulen e re mirëpo tekstet nuk janë në harmoni me këtë kurikulë.

z. Mynavere Abdullahu – Krasniqi, theksoi, në Informatë është paraqitur gjendja reale në lëmin e arsimit, mirëpo unë do të përqendrohem tek rezultatet e testit pisa, lidhur me këtë është folur shumë ngase rezultatet nuk janë të mira, mirëpo unë jam e mendimit se nuk është bërë informimi i duhur për këtë test ndërkombëtar që mbahet për herë të parë te ne. MASHT – i ka qenë mbikëqyrëse e këtij testi, mirëpo shtrohet pyetja sa kanë qenë të informuara paraprakisht shkollat por edhe nxënësit. Kësaj çështjeje publiciteti i është dhënë pas publikimit të rezultateve, andaj lidhur me këtë konsideroj se ka çaluar Ministria përkatëse.

Jemi në dijeni se testit të arritshmërisë i kushtohet kujdes ndërsa për një test ndërkombëtar informimi dhe përgatitjet nuk kanë qenë në nivel. Jam e bindur se nxënësit të cilët i janë nënshtruar testimit fare nuk kanë qenë në dijeni se testi është ndërkombëtar, ngase në të kundërtën nxënësit do të përgatiteshin dhe rezultatet sigurisht do të ishin më të mira.

Në Informatë thuhet se kabinetet në dy shkolla janë pajisur me mjete të informatikës e pastaj përmendet edhe emri i një shkolle, pra me këto pajisje janë furnizuar tri shkolla andaj do duhej të figuronin emrat e të tri shkollave e jo vetëm të njëjës.

z. Naim Çunaku, theksoi, sa i përket gjendjes në lëmin e arsimit në Komunën tonë dëgjova edhe diskutimet e atyre të cilët janë të involvuar në arsim dhe nga ato diskutime rezultoi si theks i veçantë depolitizimi i arsimit e kjo sipas mendimit tim është për keqardhje, andaj në këtë drejtim niveli qendror duhet të ndërmarrë veprime konkrete.

Çështja tjetër për të cilën e morra fjalën ishte infrastruktura shkollore, në Komunën tonë kemi bërë rrugë, kanalizime dhe shumë projekte të tjera, mirëpo nëse krahasojmë të arriturat në realizimin e projekteve të cekura dhe gjendjen në disa shkolla, po nisem prej realitetit nga vendi që vij unë, është një shpërputhje mjaftë e madhe, andaj do të dëshiroja që kur e shqyrtojmë projektbuxhetin e Komunës, në një pjesë të mjeteve buxhetore t'i destinojmë për përmirësimin e infrastrukturës shkollore. Personalisht jam i mendimit se më mirë është të mos realizohet një projekt për asfaltimin e një rruge dhe në vend të tij të realizohen projekte për shkolla në funksion të krijimit të kushteve për mbajtjen e lëndës së Edukatës fizike, këtë realitet në mund ta ndryshojmë nëse me buxhet përkatës i mbështesim kërkesat e Drejtorisë së Arsimit.

Nga disa diskutues të cilët janë të ndërlidhur në procesin edukativo – arsimor u potencua këndi shkollë - nxënës – prind dhe theksi në një formë ishte se prindërit nuk janë në nivelin e duhur në mënyrë që fëmijët e tyre të ishin më të suksesshëm, lidhur me këtë unë shtroj një pyetje, çfarë mund të kërkosh nga një prind i cili nuk di shkrim dhe lexim dhe a mund ndokush që atë prind ta involvojë në proces edukativo – arsimor. Sigurisht ju të gjithë e keni ndonjë të afërm në shtetet perëndimore dhe jeni në dijeni se çfarë është roli i prindit në procesin edukativo – arsimor, prindi vetëm e paguan taksën përkatëse dhe nuk është pjesë e këtij procesi, andaj nuk them se prindi është i parëndësishëm në këtë proces por unë e shfajësoj dhe konsideroj se më së paku është meritë për situatën aktuale në arsim.

Sa i përket rezultateve të Pisa – së, që është bërë temë në gjithë Kosovën, unë shkurtimisht them, rezultati i Pisa – së është gjendja reale e arsimit në Kosovë, lidhur me këtë nuk dëshiroj të polemizoj me z. Mynavere por unë jam i mendimit se është më mirë që nuk ka qenë informimi paraprak për këtë test ngase do të përzgjidheshin nxënësit më të mirë dhe në atë rast do të kishim një rezultat jo real e me këtë vetëm do ta gënjenim vetveten.

z. Mynavere Abdullahu – Krasniqi, theksoi, për testin Pisa nuk ka pasë mundësi të përzgjidhen nxënësit ngase kriteret kanë qenë të caktuara dhe atë në bazë vitit të lindjes.

z. Haki Rudari, theksoi, nuk pajtohem me z. Naim Çunaku lidhur me rolin e prindërve në procesin edukativo – arsimor në shtetet perëndimore dhe shtoi, unë vëllain e kam në Gjermani dhe jam mirë i informuar se çfarë roli ka prindi në këtë aspekt.

Sa i përket informimit paraprak për mbajtjen e testit Pisa jam i mendimit se sikur të bëhej kjo rezultatet do të ishin më të mira për faktin se sikur të mos informohesha më herët për këtë mbledhje sigurisht se do të isha i papërgatitur për të diskutuar.

z. Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, një ditë më parë e kemi pasë një takim me Komitetin për Arsim dhe Kulturë e kam thënë në atë takim dhe po e përsëris se gjatë debateve ka edhe interesa politike, mirëpo këto tema ende nuk i kemi hapur me profesionist në mënyrë që të gjejmë zgjidhjen e duhur. Nuk mund të pajtohem që nëse mungon një derë në një klasë të një shkolle apo në shkollën “ Ibrahim Rugova ‘ një klasë nuk ka mbajtur mësim të thuhet se gjendja në arsim nuk është e mirë, pra për 76 shkolla gjërat nuk mund të përgjithësohen.

Diskutuesi z. Rafet Llapashtica theksoi ka drejtor me tetë vite në cilësinë e ushtruesit të detyrës së drejtorit të shkollës, për këtë unë nuk jam në dijeni, jam në dijeni se ka drejtor shkolle për tri apo katër vite, por jo tetë vite, mirëpo kjo është pasojë se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore, andaj nëse diskutuesi i përmendur e ka emrin konkret le të ma thotë.

Sa i përket krijimit të kushteve për mbajtjen e lëndës së Edukatës fizike mund të them se vitin e kaluar i kemi rregulluar tri salla të jashtme dhe planifikojmë që sipas mundësive buxhetore të rregullojmë edhe salla të tjera dhe fusha sportive, andaj nuk është i qëndrueshëm konstatimi se Edukata fizike nuk mbahet.

Një diskutues tha se arsimtari i Gjuhës angleze është përkthyes, për këtë as Komuna, as Drejtoria e Arsimit e as unë nuk jemi fajtor ngase ai përkthyes në ndërkohë është diplomuar në një fakultet privat.

Për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës është në fuqi një Rregullore e cila zbatohet për këtë çështje, me përjashtim që e kam thënë edhe në mbledhje të Kuvendit se ata studentë të cilët i kanë notat e mira dhe i plotësojnë kushtet por marrin bursë edhe nga Fakulteti ku studiojnë, do të refuzohen ngase numri i studentëve të cilët kërkojnë bursë është i madh dhe nuk ka kuptim që ndonjë student të merr dy bursa e ndonjë të mos merr fare bursë.

Nëse nisemi prej debateve televizive për rezultatet e testit Pisa, debate në të cilat po merr pjesë çdo kush, është gabim shumë i madh ngase po vërehen tendenca të ndryshme, por edhe vetë Ministri i MASHT-it në një rast ka thënë se fajtor janë të gjithë mësimdhënësit e disa të tjerë i fajësojnë Drejtorinë Komunale të Arsimit, por unë jam i mendimit se nëse vazhdohet me këtë qasje nuk do të përmirësohet rezultati i Pisa – së.

Në këtë informatë i kam përfshirë edhe rezultatet e Pisa – së më të vetmin qëllim që të shikojmë se çfarë ne mund të bëjmë në nivelin komunal për përmirësimin e kësaj gjendjeje dhe sigurisht e keni vërejtur se janë edhe disa rekomandime duke përfshirë të gjithë faktorët e brendshëm relevant, pra faktorët institucional. Sa i përket rolit të prindërve, që bëjnë pjesë në faktorët e jashtëm, në kuptimin profesional prindi nuk mund të fajësohet, por mund të fajësohet një pjesë e prindërve për atë që në fund të vitit shkollor bëjnë presion tek mësimdhënësit për përmirësimin e notave, pra kjo tek prindërit duhet të evitohet.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket zgjedhjes së drejtorëve të shkollave, as Komiteti për Politikë dhe Financa e as ne këshilltarët e Kuvendit nuk mund ta marrim përgjegjësinë përse në kohën e duhur nuk janë dërguar numri i nevojshëm i mësimdhënësve të cilët i kanë plotësuar kushtet për ta kryer trajnimin e nevojshëm për të

konkurruar për drejtor të shkollave, kusht që kërkohet me dispozita ligjore dhe nënligjore, pra për këtë fajtoje është Drejtorja e Arsimit.

Pas votimit u konstatua se kjo Informatë, Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

4. Propozimi Planit lokal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës për periudhën 2017 – 2022

- Raporti për zbatimin e diskutimit publik

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, e paraqiti fjalën hyrëse.

Nuk pati diskutime dhe pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim.

5. Ngritja e Komiteteve Konsultative

- Ngritja e panelit përzgjedhës për propozimin e anëtarëve të Komiteteve Konsultative**
- Vendimi për publikimin e konkursit për anëtarësim në Komitete Konsultative**

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, sipas propozimit të vendimit, në nenin 3, Komitetet Konsultative ngritën për mandat katërvjeçar, lidhur me këtë jam i interesuar të di se këto komitete a ndërlihen me mandatin e Kuvendit apo jo.

z. Faik Gashi, shef i Zyrës ligjore, theksoi, nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kohëve të fundit, është nxjerrë një në Udhëzim i ri Administrativ i cili na obligon t'i themelojmë Komitetet Konsultative, ndërsa sa i përket mandatit të këtyre Komiteteve duhet pasë parasysh se do të shpallet konkursi dhe deri në ngritjen e tyre do të kalojë një kohë e konsiderueshme dhe do të jenë në pyetje dy apo tre muaj, por gjithsesi këto komitete janë të ndërlihdura me mandatin e Kuvendit.

z. Haki Rudari, theksoi, me dispozita ligjore, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Kuvendit parashihet ngritja e Komiteteve obligative, të përhershme dhe Komiteteve Konsultative, andaj kam pyetje për Zyrën ligjore, përse për Komitetet obligative parashihet mëditja në shumë prej 50 €, ndërsa për Komitetet tjera nuk parashihet mëditja, pra në rastin konkret kemi kundërshti ngase me dispozita ligjore parashihet ngritja edhe e Komiteteve obligative edhe Komiteteve tjera.

Andaj kjo nuk është në rregull e këtë e dëshmoi edhe kryesuesi në fjalën hyrëse me faktin se për Komunitete Konsultative disa herë është publikuar konkursi por nuk ka pasë interesim ngase për punën dhe angazhimin në këto Komitete nuk është paraparë kompensimi – mëditja. Përndryshe jam në dijeni se në komunat tjera, përveç komiteteve obligative paguhen edhe komitetet tjera.

z. Faik Gashi, shef i Zyrës ligjore, theksoi, sipas dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale janë komitetet obligative dhe atë Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete si dhe Komitetet tjera të përhershme. Me Udhëzimin Administrativ përkatës për angazhim në këto komitete është paraparë kompensimi në formë të mëditjes në shumë prej 50 €, ndërsa për komitete të tjera nuk është paraparë kurrfarë

kompensimi. Tani me Udhëzimin për themelimin e Komiteteve Konsultative gjithashtu është paraparë kompensimi në shumën e mëditjeve të Komiteteve obligative.

Disa komuna në Republikën e Kosovës, me buxhet komunal, e kanë rregulluar çështjen e pagesës së mëditjeve për Komitetet jo obligative.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, pyetja e z. Haki Rudarit është mjaft e qëlluar ngase shtrohet pyetja përse të kompensohen anëtarët e Komiteteve Konsultative ndërsa të mos kompensohen anëtarët e Komiteteve të përhershme të Kuvendit, mirëpo tani për tani është kjo gjendje ngase kompensimi për anëtarët e Komiteteve Konsultative është paraparë me Udhëzim Administrativ të nivelit qendror dhe ne jemi të obliguar për ta zbatuar.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim, me konstatim që pas konsultimit me shefat e Grupeve të këshilltarëve, në mbledhjen e Kuvendit të propozohet struktura dhe anëtarët e Panelit përzgjedhës për propozimin e anëtarëve të Komiteteve Konsultative.

6. Ngritja e Komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me emërtimin e disa rrugëve në territorin e Komunës së Podujevës

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Naim Çunaku, theksoi, duke e pasë parasysh se kam qenë anëtar i Komisionit të ngritur nga Kuvendi për propozimin e emërtimit të rrugëve në territorin e Komunës së Podujevës, Komision në të cilin kanë qenë edhe disa anëtarë të cilët janë të pranishëm në këtë mbledhje duke përfshirë edhe kryesuesin e këtij Komiteti përkatësisht Kuvendit, që ka qenë kryetar i atij Komisioni, andaj jam i interesuar të di se mbi çfarë baze ligjore apo nënligjore mund të themelojmë Komision për shqyrtimin e ankesave lidhur me emërtimin e rrugëve.

Kryesuesi në fjalën hyrëse tha se në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit janë adresuar një numër i ankesave lidhur me emërtimin e rrugëve, shtrohet pyetja përse ankesat i janë drejtuar Drejtorisë së cekur, cili është roli i Drejtorisë në rastin konkret kur kjo çështje është kompetencë e Kuvendit.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, disa ankesa janë drejtuar tek unë në cilësinë e kryesuesit të Kuvendit e disa të tjera në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, mirëpo Drejtoria e përmendur nuk ka kompetencë për t'i shqyrtuar ato ankesa, andaj kam qenë i mendimit se organi i vetëm që mund t'i shqyrtoj ato ankesa është Kuvendi. Jeni në dijeni se gjatë një viti e më shumë çfarë pune dhe angazhimi është bërë për marrjen e propozimeve për emërtimin e rrugëve, kemi komunikuar me qytetarë dhe të gjitha subjektet relevante dhe në shumë raste kemi gjetur gjuhë të përbashkët por ju kujtohet se në raste të caktuara kemi bërë edhe kompromise. Jam i bindur se shumica e ankesave janë të pabazuara, ndoshta ka ndonjë me bazë, por sido qoftë është rregull që në ankesa të kthehen përgjigje.

Mirëpo lidhur me këtë kërkoj që para mbledhjes së nesërme të Kuvendit, Zyra ligjore të na jep sqarimet përkatëse, përkatësisht se a ka mbështetje ligjore për formimin e Komisionit të cekur apo jo.

z. Kadri Avdiu, theksoi, mua më shqetëson më së tepërmi se ndoshta është ndërhyrë në emërtime të rrugëve pas miratimit të Vendimit nga ana e Kuvendit, këtë e them në bazë të disa informacioneve të pa verifikuara se për një rrugë është ndryshuar emërtimi, nëse

ka raste të këtilla ndaj kujtdo çoftë duhet të ngritët padia, ngase rastet e këtilla janë falsifikime.

Por nëse ka ankesa të tilla, që edhe mua më kanë thirr në telefon dhe më kanë thënë unë nuk kam qenë i informuar dhe një rrugë është dashtë të emërtohet me emrin e vëllait tim, kjo është krejt diçka tjetër, pra ankesat e këtilla janë të pabazuara.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, materiali i Vendimit për emërtimin e rrugëve u është dërguar të gjithë këshilltarëve të Kuvendit, pas miratimit në mbledhjen e Kuvendit të nesërmen e kam kërkuar nga Zyra ligjore materialin përkatës dhe i kam nënshkruar çdo listë veç e veç dhe Vendimi është dërguar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për shqyrtim të ligjshmërisë.

Përndryshe listat e miratuara të emërtimeve të rrugëve janë publikuar me kohë në web faqen zyrtare të Komunës.

Pajtohem me parafolësin se nëse ndokush eventualisht ka bërë ndryshime në listat e miratuara të emërtimeve të rrugëve, kjo është vepër penale dhe duhet të bartë përgjegjësi ligjore, mirëpo personalisht nuk besoj se është bërë ndonjë ndryshim i këtillë.

Përndryshe ne e kemi materialin dhe mund të bëjmë krahasime se eventualisht a është ndryshuar emërtimi i ndonjë rruge.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, Kuvendi ka të drejtë të ngritë Komision e cekur, mirëpo kjo nuk do të thotë se Kuvendi i mbështet propozimet e atij Komisioni, derisa Kuvendi ka pasë kompetencë për ngritjen e Komisionit për propozimin e emërtimeve të rrugëve, sigurish ka kompetencë edhe për ngritjen e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të ndërlidhura me emërtime të rrugëve.

Konsideroj se në këtë aspekt duhet të rishikohen të gjitha lëshimet eventuale dhe nëse ngritët Komisioni i ankesave ky duhet të caktoj takime me Komisionin për propozimin e emërtimeve të rrugëve dhe t'i shqyrtojnë çështjet bashkërisht. Lidhur me këtë personalisht nuk besoj se ka pasë ndërhyrje të qëllimshme por nuk përjashtohen gabimet eventuale.

Në fund dua të them edhe këtë se gjatë debatit nuk u përmend afati për ushtrimin e ankesës, ashtu siç nuk u përmend se me dispozita ligjore është paraparë lista rezervë e emërtimeve të rrugëve, listë e cila është miratuar, e që emërtimet e mëvonshme duhet të merren nga ajo listë.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, edhe më parë e thashë dhe po e përsëris, propozimi im është që të kërkojmë sqarime nga Zyra ligjore se a kemi bazë ligjore për ngritjen e këtij Komisioni, sqarime të cilat duhet të jepen nesër para fillimit të mbledhjes.

z. Naim Çunaku, theksoi, Kuvendi në parim ka të drejtë të ngritë Komisione të ndryshme, mirëpo ai komision duhet të ketë mbështetje në ndonjë Rregullore konkrete për veprimtarinë që e trajton dhe kompetencat e tij, në formën të cilën e kemi për ngritjen e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të cilat i janë drejtuar Kuvendit dhe një Drejtorie komunale, në këtë rast nuk kemi nevojë të ngritim komision.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim me konstatim që nëse ka mbështetje ligjore, pas konsultimit me shefat e Grupeve të këshilltarëve të propozohet struktura dhe anëtarët e Komisionit.

7. Propozimi i vendimit për zëvendësimin e dy anëtarëve të Komisionit vlerësues për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim

Nuk pati diskutime dhe pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim, me konstatim që emrat e anëtarëve të ri të propozohen në mbledhje të Kuvendit.

8. Propozimi i Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të paluajtshmërisë në pronësi të Komunës, Ministrisë së punës dhe Mirëqenies Sociale, për ndërtimin e objektit të Qendrës së Aftësimeve Profesionale.

Duke u bazuar në sqarimet e paraqitura me rastin e përfshirjes së kësaj çështjeje në rend dite, nuk pati diskutime dhe pas votimit u konstatua se me 9 vota për, asnjë kundër dhe 1 votë të përmbajtur, Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 14.45’.

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01- 060/04-5942/17
Podujevë,
1 shkurt 2017**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**